



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-343/07-126477/25, më 21 AUG 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet ndërmarrja e masave për mbushjen e përkohshme të gropave ndërtimore të krijuara nga ndërtime pa leje ose në kundërshtim me lejen ndërtimore.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbushja e përkohshme e gropave ndërtimore të krijuara nga ndërtime pa leje ose në kundërshtim me lejen ndërtimore në territorin e Komunës së Prishtinës, do të bëhet për lokacionet për të cilat ekzistojnë aktvendime për rrënim, urdhra për ndërmarrjen e masave të sigurisë në vend ndërtim dhe akteve për rrënim të lëshuara nga Drejtoria e Inspektionit.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, do të kujdeset për organizimin dhe realizimin e mbushjes së këtyre gropave, në në koordinim me drejtoritë tjera relevante në kuadër të Kryeqytetit.
4. Materialet inerte të nxjerra nga punishtet e projekteve publike komunale mund të përdoren për këtë qëllim, me miratim të menaxherit të kontratës për rrënim dhe në koordinim me mbikëqyrësit teknikë të projekteve publike.
5. Menaxheri i kontratës për rrënim do të kujdeset për raportimin e realizimit të çdo mbushjeje pranë Drejtorisë së Inspektionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- DIKMK-së;
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

